



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 8.11.2023, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Klotilda Bushka – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” për institucionet publike të pavarura dhe ato kushtetuese:

Seancë dëgjimore me Ministrinë e Drejtësisë

Seancë dëgjimore me ILDKPKI-në

Seancë dëgjimore me Gjykatën Kushtetuese

Seancë dëgjimore me Komisionerët Publikë

Seancë dëgjimore me Presidencën

Marrin pjesë:

Klotilda Bushka, Ermonela Valikaj (Felaj), Dhurata Çupi (Tyli), Denis Deliu, Xhemal Qefalia, Jurgis Çyrbja, Klevis Xhoxhi, Eduard Ndreca, Toni Gogu, Greta Bardeli, Damian Gjikhuri, Saimir Hasalla, Bledion Nallbati, Saimir Korreshi, Aurora Mara, Asllan Dogjani, Petro Koçi, Erisa Xhixho, Oerd Bylykbashi, Gledis Çeliku dhe Dashnor Sula.

Mungojnë:

Elda Hoti, Enkelejd Alibeaj, Fatmir Mediu, Gerta Duraku, Fatmir Xhafaj dhe Gazment Bardhi dhe Pandeli Majko.

Të ftuar:

Ulsi Manja – ministri i Drejtësisë

Ismail Shehu – sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë

Suzana Stefa – këshilltare e ministrit të Drejtësisë

Arbër Basholli – sekretar i Përgjithshëm i ILDKPKI-së

Mirela Gega – inspektor në ILDKPKI

Eugen Papandile – sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese

Erion Tafaj – drejtor i Drejtorisë Ekonomike dhe Burimeve Njerëzore në Gjykatën Kushtetuese

Florian Ballhysa – komisioner Publik

Irena Nino – komisionere Publike

Alketa Çeli – kancelare e Komisionerit Publik

Valbona Lusha – sekretare e Përgjithshme e Presidencës

Arjan Kadareja – këshilltar i Presidentit të Republikës

Idlir Gjata – ndihmës i Presidentit të Republikës

Vilma Çausholli – përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programimit Buxhetor në Ministrinë e Financave

HAPET MBLEDHJA

Klotilda Bushka – Mirëdita, kolegë!

Duke qenë se kuorumi i nevojshëm për vlefshmërinë e mbledhjes është i pranishëm, nisim mbledhjen e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut nëpërmjet mjeteve të komunikimit elektronik sipas njoftimeve të ditës së djeshme me rend këtë dite: shqyrtimin e projektligjit “Për buxhetin e vitit 2024” (jemi në momentin e dëgjësave) për institucionet publike të pavarura dhe ato kushtetuese.

Sot është caktuar dëgjësë me ministrin e Drejtësisë, me ILDKPI-në, me Gjykatën Kushtetuese, me Komisionerët Publikë dhe me Presidencën.

Relatorë janë zoti Klevis Xhoxhi dhe zoti Saimir Hasalla.

Fillojmë me pikën e parë të rendit të ditës.

Nga Ministria e Drejtësisë kemi prezent *online* ministrin e Drejtësisë, zotin Ulsi Manja. Mirë se vini në këtë mbledhje, zoti Ministër!

Ai është i shoqëruar nga zoti Ismail Shehu, sekretar i Përgjithshëm, dhe zonja Suzana Stefa, këshilltare e ministrit të Drejtësisë.

Janë prezentë nga Ministria e Financave, zonja Vilma Çausholli, përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Analizës dhe Programit Buxhetor.

Zonja Çausholli i njeh të gjitha buxhetet e institucioneve në fushën e përgjegjësisë së këtij komisioni.

Mirë se edhe, zonja Çausholli!

Nisim me dëgjësën e parë. Zoti Manja, fjala është për ju për të kuptuar realizimin e treguesve buxhetorë të vitit 2023, nevojat për vitin 2024 dhe adresimin e tyre në projektligjin që kemi në shqyrtim.

Fjala për ju, zoti Ministër.

Teknika, fjalën ministrit.

Ulsi Manja – Përshëndetje dhe mirëmëngjesi!

Për mua është kënaqësi të jem në Komisionin e Ligjeve dhe kësaj radhe për prezantimin e buxhetit afatmesëm dhe të buxhetit të vitit 2024. Besoj që edhe kësaj radhë për disa nga kërkesat tona, që janë mbi tavanet buxhetore, të gjejmë mbështetjen e Komisionit të Ligjeve, siç e keni gjetur çdoherë, por shpresojmë në finale, pse jo, edhe të Komisionit të Ekonomisë, pra për akomodimin e tyre.

Në përgjithësi ne si Ministri e Drejtësisë jemi dakord me buxhetin e vitit 2024 dhe e kemi votuar këtë buxhet në Këshillin e Ministrave. Pra, buxheti afatmesëm dhe buxheti i vitit 2024 vjen me rritje.

Buxheti afatmesëm 2024-2026, i ndarë në vite, është: viti 2024, 14,6 miliardë, viti 2025, 15,8 miliardë dhe viti 2026, 16,4 miliardë. Pra, buxheti afatmesëm i Ministrisë së Drejtësisë, i rakorduar edhe me Ministrinë e Financave, në afatmesëm vjen me ngritje.

Në lidhje me buxhetin e vitit 2024, na është akorduar një buxhet 14,6 miliardë lekë me një rritje prej 1,7 miliardë lekësh, ose rreth 8,7% më shumë se buxheti 2023, i cili ka qenë 12,9 miliardë lekë, referuar aktit normativ të tetorit 2023. Nga kjo rritje prej 1,7 miliardë lekësh në buxhetin Ministrisë së Drejtësisë, në fakt 1,2 miliardë lekë shkojnë për shpenzime personeli, paga plus sigurime shoqërore.

Shpenzimet korrente janë rritur me 28,3 milionë lekë dhe te shpenzimet korrente janë shtuar 595 milionë lekë fond për kompensimin financiar të ish-pronareve; 74 milionë lekë për aparatin e Ministrisë së Drejtësisë, për sektorin e përkthimeve, por është pakësuar fondi kryesisht në sistemin e burgjeve me rreth 523 milionë lekë. 480 milionë lekë, nga 1,7 miliardë lekë në rritje që vjen buxheti ynë për vitin 2024, janë shpenzimet për investime kapitale të brendshme. Konkretisht, 233,8 milionë lekë do të shkojnë për përmirësimin e sistemit të regjistrimit elektronik noterial; 120 milionë lekë do të shkojnë për Institutin e Mjekësisë Ligjore për ndërtimin e dhomës frigoriferike dhe blerjen e pajisjeve përkatëse, për të pasur një shërbim modern edhe në Institutin e Mjekësisë Ligjore; 80 milionë lekë shkojnë për laboratorin e toksikologjisë në IML; 50 milionë lekë për blerjen e pajisjeve speciale dhe për kontrollin e sigurisë në sistemin e burgjeve. Këto shpenzime janë brenda tavaneve buxhetore për vitin 2024 dhe përfshihen në buxhetin tonë prej 14,6 miliardë lekësh.

Nuk dua të ndalem te projektet kryesore të investimeve brenda tavaneve buxhetore për vitin 2024, sepse në vija të përgjithshme i thashë, por dua të ndalem te disa nga kërkesat shtesë mbi tavanet buxhetore. Në total ato shkojnë rreth 1,3 miliardë lekë, por do t'i konsideronim të domosdoshme kërkesat shtesë për investimet publike në vlerën 634 milionë lekë. Nëse do të merren në konsideratë nga Komisioni i Ligjeve dhe nga Ministria e Financave, do të na zgjidhin disa gjëra që i kemi shumë të nevojshme dhe të domosdoshme. Nëse jo, shpresojmë me aktin normativ të vitit tjetër, por do të kërkonim ndihmë tani.

300 milionë lekë i kërkojmë për përmirësimin e sistemit "ALBIS" të Shërbimit Përmbartimor Shtetëror: 251,4 milionë lekë i duam për implementim e këtij sistemi dhe 49 milionë lekë duam për mirëmbajtjen. Është urgjente, sepse ka 2 vjet pa mirëmbajtje. Pra, praktikisht regjistri elektronik i Shërbimit Përmbartimor Gjyqësor publik është jashtë

funkcionit. Është sistemi i ndërtuar, por, duke qenë se ka 2 vjet pa mirëmbajtje, sigurisht që ka nevojë për përmirësim të sistemit dhe për mirëmbajtje.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve kemi nevojë për shtesë në masën 315 milionë lekë, e ndarë në: 286,5 milionë lekë për përmirësimin e kushteve fizike të jetesës nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës në disa nga institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale; 25 milionë lekë për sistemin e menaxhimit të informacionit, të protokollit dhe sallën operative për SHKBB-në dhe kemi nevojë për 4 milionë lekë për studime dhe projekte, sepse kemi disa IEVP që duam t'i fusim në proces rikonstruksioni vitin që vjen.

Për sa i përket Shërbimit Përmbarrimor, kemi nevojë për 14 milionë lekë për të bërë rikonstruksionin e ambienteve të Shërbimit Përmbarrimor në Tiranë.

Kemi nevojë për 3 milionë lekë për pajisjen e zyrave të arkivit shtetëror të sistemit gjyqësor me mjete elektronike.

Në lidhje me kërkesat shtesë për shpenzimet operative, që ne i konsiderojmë të domosdoshme, 712 milionë lekë i kërkojmë kryesisht për sistemin e burgjeve: 576 milionë lekë për sigurimin e vazhdimësisë së zbatimit të kontratave për uniformat e Policisë së Burgjeve; 66,2 milionë lekë shpenzime për energjinë elektrike dhe 70 milionë lekë për aparatin e ministrisë, kryesisht për përkthime.

Gjithashtu, dua të ndalem pak te kërkesat shtesë për përkthime. Në fakt, në vitin 2023, në raport me vitin 2022, ky zë shpenzimesh buxhetore në Ministrinë e Drejtësisë ka ardhur shumë në rritje, për një arsye shumë të thjeshtë: është shtuar dinamika e letërporosive, qoftë të SPAK-ut, por edhe të Prokurorisë së Juridiksionit të Përgjithshëm. Pra, gama e volumi të letërporosive në vitin 2023, në raport me vitin 2022, pothuajse është trefishuar. Nëse gjatë vitit 2022 për përkthimet zyrtare ne kishim një vlerë 61,6 milionë lekësh, për vitin 2023 vetëm si 6-mujor është 46,8 milionë lekë, ndërsa deri në fund të vitit kjo vlerë do të shkojë rreth 900 milionë lekë. Ne e kemi të pamundur, nëse nuk na shtohet kjo sasi modestesh parash në zërin e përkthimeve, t'u përgjigjemi nevojave dhe kërkesave që kanë organet e hetimit për sa i takon ndihmës juridike në fushën penale, kryesisht nëpërmjet letërporosisë, por edhe bashkëpunimit që kjo prokurori ka me *Eurojust*-in. Pra, kërkesat tona shtesë, mbi tavanet buxhetore, në total janë rreth 1,3 miliardë lekë. Ndoshta është e pamundur të bëhet i gjithë akomodimi i kërkesave mbi tavanet buxhetore, për disa nga këto kërkesa që ne i konsiderojmë të nevojshme dhe të domosdoshme, do të ishte mirë që të na mbështesni. Këto kemi për buxhetin vitit 2024.

Dua ta mbyll aty ku e nisa në fillim: jemi dakord me buxhetin, sepse është buxhet që vjen me 1,7 miliardë rritje, dhe nuk është pak, është rreth 8,7%, por kryesisht kjo reflekton rritjen e pagave të punonjësve të Ministrisë së Drejtësisë në sektorin publik.

Edhe një herë, dua t'ju falënderoj dhe jam i hapur për përgjigjet e pyetjeve që mund të kenë kolegët e mi deputetë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Ministër!

Fjalën do ta marrin relatorët. Cili nga relatorët e do fjalën?

Zoti Xhoxhi dhe më pas zonja Çausholli.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Mirëmëngjesi, kolegë deputetë!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin që sapo i bëtë projektbuxhetit këtu në komision! Njëkohësisht, ju përgëzoj për punën e mirë që keni bërë gjatë gjithë kësaj kohe për realizimin e detyrave në Ministrinë e Drejtësisë.

Kolegë, ashtu si institucionet e tjera, edhe projektbuxheti i vitit 2024 për Ministrinë e Drejtësisë vjen me një rritje prej 1,72 miliardë lekësh ose 13,2% më shumë.

Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë për vitin 2024 është parashikuar të jetë 14,68 miliardë lekë, nga të cilat 7 miliardë lekë do të jenë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 1,9 miliardë lekë do të jenë shpenzime për mallra dhe shërbime; 4,1 miliardë lekë do të jenë për subvencione dhe 1,83 miliardë lekë do të jenë shpenzime për investime. Njëkohësisht, numri i punonjësve për Ministrinë e Drejtësisë për vitin 2024 është parashikuar të jetë 5 373 punonjës. Sikundër e thashë, kemi një rritje të buxhetit të vitit 2024 për Ministrinë e Drejtësisë, kryesisht kemi rritje në shpenzime dhe paga 1,2 miliardë lekë, ose 21% më shumë; kemi shpenzime për mallra dhe shërbime, ku ka një rënie prej 591 milionë lekësh, ose 23,5% më pak, dhe zëri i institucioneve ka pësuar një rritje prej 600 milionë lekësh ose 17% më shumë. Shpenzimet për investimet janë rritur në vlerën 480 milionë lekë ose 46% më shumë, ndërsa te numri i punonjësve kemi një rënie prej 5 punonjësish.

Po të krahasojmë realizimin e buxhetit për 9-mujorin e parë të vitit 2023, kemi një realizim në masën 75,6% për shpenzime dhe paga, në masën 42% për mallra dhe shërbime dhe investimet 4,5%.

Ministri Manja i theksoi vetë kërkesat dhe nevojat mbi tavanin buxhetor. Kështu që, kolegë, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave, por edhe me sugjerimet dhe mbështetjen tuaj, pas diskutimeve, të konkludojmë për t'i paraqitur raportin Komisionit të

Ekonomisë. Kjo ishte, pak a shumë, një tablo e thjeshtuar e projektbuxhetit të vitit 2024 dhe e realizmit të buxhetit nga ana e ministrisë për vitin 2023.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Mendoj se nuk kemi çfarë të shtojmë më shumë. Buxheti i Ministrisë së Drejtësisë njih rritje në të gjithë zërat e tij. Në krahasim edhe me buxhetin fillestar të vitit 2023, rritja është akoma edhe më e ndjeshme nga sa shprehu zoti ministër. Kështu që kërkesat shtesë janë prioritet brenda buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë dhe mendoj se duhet të zgjidhen brenda atij buxheti.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Çausholli!

Në fakt, janë të qarta cilat janë kërkesat buxhetore, të cilat janë shtesë, tej atyre që parashikohen në projektbuxhetin e vitit 2024. Ne me kolegët e komisionit kemi bërë edhe një vizitë monitoruese në Shërbimin Përmbartimor, dhe mua më vjen mirë që ministri sot i ka përfshirë e i ka adresuar në kërkesat e ministrisë ato nevoja që kishte ky shërbim. Mendoj se mbështetja e mirëmbajtjes së sistemit të Shërbimit Përmbartimor është e rëndësishme, ashtu si edhe mjediset e zyrave kanë nevojë për t'u rikonstruktuar. Nga ana tjetër, duke qenë se kemi bërë një reformë për Shërbimin Përmbartimor, duhet t'i pajisim ato që të kenë mundësi për një pune eficiente dhe më pas të kërkojmë edhe rezultatet që presim. Pa diskutim, rezultatet vijnë edhe duke i ndihmuar institucionet që të punojnë sot me mjete të digjitalizuara, siç është edhe sistemi. Në qoftë se sistemi nuk punon, është e vështirë të rakordohen me njëri-tjetrin institucionet, por edhe të drejtat e shtetasve për t'u ekzekutuar vendimet e tyre sa më parë dhe sa më mirë që të jetë e mundur.

Te kërkesat e tjera unë nuk po ndalem më, sepse shikoj se ka një lloj dakordësie, vetëm, zoti Ministër, ne do të donim që këtë kërkesë shtesë, që bëtë sot, ta kishim me shkrim, në mënyrë që relatorët, Ministria e Ekonomisë dhe institucioni juaj të rakordoni për mënyrën sesi do të adresohen ato në projektbuxhet, pra si kërkohen të adresohen dhe më pas të jenë objekt diskutimi në Komisionin e Ligjeve, që më pas të bëhet procesi për sugjerimet që ne do t'i bëjmë Komisionit përgjegjës të Ekonomisë.

Kolegë, a keni pyetje dhe diskutime?

Zoti Ministër, e kërkoni edhe një herë fjalën?

Ulsi Manja – Po, dua të shpreh diçka.

Në lidhje me realizmin e buxhetit të vitit 2023, është e vërtetë ajo që tha kolegu Xhoxhi se realizimi i buxhetit të Ministrisë së Drejtësisë për investimet është në masën 4%, por, nëse do të marrim fondet obliguara dhe të realizuara, sot që flasim ne shkojmë në 75%, sepse këto ditë është finalizuar edhe projekti i Institutit të Miturve dhe Ministria e Drejtësisë ka publikuar klasifikimin e subjekteve dhe të operatorëve që morën pjesë në këtë garë dhe deri në fund të vitit, përfshirë edhe realizmin e buxhetit që kanë burgjet, ne mendojmë që në zërin e investimeve ta mbyllim me 95% të buxhetit të vitit 2023 të realizuar.

Unë e thashë që në fillim se buxheti ynë vjen me një rritje 8,7%, dhe ne jemi të kënaqur me këtë buxhet, por janë disa kërkesa që nuk arrijmë dot t'i mbyllim brenda këtij buxheti, siç tha edhe zonja Çausholli. Për shembull, masa 70 milionë për përkthimet është domosdoshmëri, sepse është një shërbim që ne e ofrojmë për sistemin gjyqësor dhe këtë gjë nuk mund ta zgjidhim sot që flasim. Ndërsa në lidhje me kërkesat shtesë, sidomos për sa i takon edhe sistemit të përmbarrimit dhe ambienteve të përmbarrimit, unë bashkohem me konstatimin që ka bërë dhe Komisioni i Ligjeve në rubrikën studimore. Gjithsesi, ne do t'jua sjellim kërkesat shtesë me shkrim dhe mbështetjen e këtyre kërkesave e lëmë në vlerësimin e Komisionit të Ligjeve, por edhe në një bisedë që mund të zhvillojmë këto ditë me Komisionin e Ligjeve, me Ministrinë e Financave dhe me Komisionin e Ekonomisë.

Faleminderit për vëmendjen dhe për mbështetjen!

Klotilda Bushka – Faleminderit për shpjegimin, zoti Ministër!

Ju thatë se keni një realizim më të lartë këtë vit, duke qenë se tashmë sapo keni mbaruar fazën përkatëse për institucionin e ri të edukimit të të miturve. Ky është një lajm shumë i mirë, sepse vitin e kaluar kemi ngulur këmbë që të kemi një institucion të ri për të miturit, të cilët janë në konflikt me ligjin. Nga ana tjetër, kemi kërkuar që të merren masa për burgun e ri të grave. Ne, të gjitha gratë deputete, kemi bërë vizitë në burgun e grave dhe kemi kërkuar të bëjmë çfarë është e mundur që gratë të lëvizin nga ai vend dhe të gjenden mjedise apo mundësi për kushte të përshtatshme, që edhe ato që kanë kryer veprime në kundërshtim me ligjin, vepra penale apo kundërvajtje dhe janë atje, të trajtohen me dinjitet, sepse edhe riintegrimi në shoqëri është shumë i rëndësishëm dhe fillon që nga mënyra sesi trajtohen. Ju përmendët studime, projekte, a janë këto në proces dhe a përfshihet këtu zgjidhja për godinën e burgut të grave?

Ulsi Manja – Po, përfshihet burgu i grave, rikonstruksioni i IEVP-së në Fushë Krujë dhe rikonstruksioni i IEVP-së në Rrogozhinë.

Klotilda Bushka – Pra, jeni drejt një zgjidhje për shqetësimin që ngre unë për sa i takon burgut të grave?

Ulsi Manja – Unë dua t'ju falënderoj që është në vëmendjen dhe në shqetësimin e Komisionit të Ligjeve trajtimi me dinjitet i grave të dënuara dhe të paraburgosura. Po punojmë në mënyrë intensive që të gjejmë një zgjidhje, sepse ai institucion sot nuk plotëson asnjë standard për të garantuar të drejtat dhe trajtimin e grave të dënuara dhe të paraburgosura. Sigurisht, kemi diskutuar dhe zgjidhje të ndërmjetme. Më lejoni të them, për dijeninë e komisionit, se nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve na është ofruar dhe na është propozuar që gratë e dënuara të lëvizin përkohësisht në institucionin e ri të Pojskës në Pogradec, i cili është në fazën e mobilimit dhe është një institucion modern për sa i takon infrastrukturës që ofron, por ne si Ministri e Drejtësisë akoma nuk jemi të vendosur për t'i dhënë zgjidhje këtij propozimi, pasi Pogradeci për të ofruar shërbime për trajtimin e grave të dënuara dhe të paraburgosura për momentin na rezulton se është pak larg Tiranës, kështu që ne ende nuk jemi shprehur për këtë. Duam të gjejmë një zgjidhje afatgjatë të përhershme me ndërtimin e një burgu të ri për gratë. Kjo është arsyeja që ne kemi kërkuar një sasi lekësh për studime dhe projekte, sepse projekti që ekziston ka nevojë për rikualifikim dhe përditësim. Ky projekt është bërë para 5 vjetëve. Projekti është që burgu të ndërtohet aty ku është, por që, në fakt, sot aty ku është nuk i plotëson standardet, edhe po u ndërtua burg i ri, sepse është i rrethuar i gjithi me pallate dhe është kthyer në një zonë banimi. Burgu i grave ka ngelur si oborr në mes të blloqeve të pallateve. Në rekomandimet që na vijnë, ndërtimi i një burgu të ri aty ku është përsëri nuk i plotëson standardet, edhe po u ndërtua si burg i ri, sepse kërkon të respektohet dhe në ajrim, edhe në shërbime privatësia që ligji dhe rregullorja u kana garantuar grave dhe të dënuarve të paraburgosura.

Gjithsesi, ju falënderoj për mbështetjen që na jepni, sepse bashkërisht e kemi domosdoshmëri adresimin e këtij problemi.

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Ministër!

Mendoj që, duke qenë se dhatë shpjegime, të cilat tregojnë se ministria dhe të gjitha institucionet përkatëse po merren me këtë çështje, ju lutem, vijoni që të gjeni një zgjidhje sa më shpejt.

Mendoj se Ministria e Ekonomisë në lidhje me studimet dhe projektimet për këto institucione, që janë prioritare, sepse hyjnë te mbrojtja efektive e të drejtave të njeriut dhe trajtimi njerëzor, do të jetë mbështetëse. Pa diskutim, edhe komisioni ynë është mbështetës në këtë drejtim.

Kështu që, duke qenë se nuk shoh që kolegët e tjerë po e kërkojnë fjalën, edhe një herë, relatorët, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave rakordoni shtesat, nevojat e reja në përputhje me atë që themi që gjithmonë, me parimin e prioritizimit të nevojave dhe të

mundësive tona buxhetore, si dhe prioriteteve politike. Pra, kini parasysh që edhe digjitalizimi është i rëndësishëm, edhe modernizimi i punës, në mënyrë që të lehtësohen qytetarët nga shërbimet që marrin nga shteti, është gjithashtu një politikë prioritare, kështu që, besoj se të gjithë i keni në konsideratë këto çështje.

Ministër, faleminderit që ishit me ne sot!

Ulsi Manja - Faleminderit!

Punë të mbarë!

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Punë të mbarë edhe ju!

Vazhdojmë me dëgjesën tjetër, me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave.

Prezent janë zoti Arbër Basholli, sekretar i Përgjithshëm, dhe një nga inspektorët, zonja Mirela Gega.

Zoti Basholli, mirë se erdhët!

Zonja Gega, mirë se erdhët në mbledhjen *online* të komisionit!

Ju ishit *online* dhe na ndoqët për procedurën që ndjekim. Kështu që ne duam një prezantim nga ju, në radhë të parë, për realizimin e treguesve buxhetorë të vitit 2023, për nevojat që keni për vitin 2024 dhe sa janë adresuar ato në projektligjin e buxhetit të viti 2024.

Fjala për zonjën Mirela Gega.

Teknika, ju lutem!

Mirela Gega - E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë, anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Duke ju falënderuar dhe vlerësuar për ftesën e institucionit të ILDKPKI-së, në kudër të të gjitha institucioneve të pavarura, për të dëgjuar dhe diskutuar rreth çështjeve dhe problematikave, të cilat na shqetësojnë në shqyrtimin e një projektligji mjaft të rëndësishëm, siç është miratimi i buxhetit, e gjej me vend të falënderoj ekspertët e Ministrisë së Financave, të cilët kanë hartuar projektin, si dhe Kuvendin për bashkëpunimin e vazhdueshëm me ILDKPKI-në!

ILDKPKI-ja, në zbatim të dispozitave ligjore dhe rekomandimeve të dhëna nga Kuvendi i Shqipërisë, me synim forcimin e mëtejshëm të instrumenteve të hetimit administrativ, deklarimit të kontrollit të pasurive dhe parandalimit dhe zgjidhje e rasteve të konfliktit të interesave të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë, në administratën e publike dhe hetimin e rasteve të sinjalizimit të jashtëm për denoncimet e bëra në Inspektoratin e Lartë, i ka kushtuar një vëmendje të veçantë hartimit të projektbuxhetit

afatmesëm 2024-2026. Konkretisht, për realizimin e objektivave dhe prioriteteve të përmendura më sipër, në projektbuxhetin e vitit 2024 ILDKPKI-ja ka të parashikuar 223 milionë e 480 mijë lekë ,të detajuara si më poshtë: shpenzime korrente 220 milionë e 480 mijë lekë dhe investime 3 milionë lekë.

Ky parashikim buxhetor është i pamjaftueshëm për përmbushjen e objektivave nga institucioni, konkretisht, në zërin e shpenzimeve korrente ka një diferencë, mosmbulim nga buxheti i shtetit për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore në shumën 13,6 milionë lekë. Kjo diferencë vjen duke bërë një përlllogaritje të detajuar të efektit të vendimit të fundit të Këshillit të Ministrave për ndryshimin e pagave të administratës publike.

Në konsultim me Ministrinë e Financave është bërë njëlloj rakordimi dhe Ministria e Financave e ka pranuar që ka një diferencë të tillë. Në vijim do të kemi edhe mendimin e Ministrisë së Financave, të cilin nuk e kemi zyrtarisht.

Për më tepër, shkak për këto ndryshime me rëndësi për institucionin, si në planin organizativ të brendshëm, në përmbushjen të detyrimit për plotësim të organikes së shtuar, ashtu edhe në drejtim të përmirësimit, me qellim forcimin e mëtejshëm të infrastrukturës së teknologjisë, ka lindur nevoja për një kërkesë shtesë në zërin e investimeve. Kështu, nevoja për riorganizim institucional, për shkak edhe të shtimit të numrit të punonjësve, por njëkohësisht përfundimi i procesit të digjitalizimit të dokumentacionit arkivor të institucionit, krijoi mundësinë për një ridimensionim të hapësirave të brendshme të institucionit, kryesisht me fokus rishikimin e hapësirave për përmirësimin e hapësirave të serverëve të institucionit.

Konkretisht, investimi ka si qëllim riorganizimin e ambienteve dhe rritjen e kapaciteteve të serverëve në drejtim të azhurnimit të infrastrukturës me standardet TIK për administratën publike. Ambientet e serverëve janë pika kyçe në një sistem informatik dhe përqendrimi i pajisjeve kompjuterike, mekanike, elektrike dhe elektronike është më i lartë se në ambientet e tjera të punës. Kështu që, dëmet eventuale të shkaktuara do të sillnin probleme serioze në funksionimin e të gjithë sistemit.

Ndërhyrja parashikon blerjen e disa pajisjeve teknologjike, si dhe kryerjen e zhvillimeve të specializuara në drejtim të përmirësimit dhe forcimit të mëtejshëm infrastrukturës TIK. Ky projekt, sipas një vlerësimi paraprak të bërë nga institucioni, është në shifrën 35 milionë lekë.

Për të konkluduar, për sa më sipër, kërkojmë mbështetjen tuaj në shumë 48,6 milionë lekë, të detajuar. Konkretisht: kërkesë për fonde shtesë në zërin “Shpenzime për paga dhe

sigurime” në shumën 13,6 milionë lekë dhe kërkesë për fonde shtesë në zërin “Investime” në shumën 35 milionë lekë. Ju faleminderit!

Klotilda Bushka - Ju faleminderit, zonja Gega!

Zoti Xhoxhi, keni fjalën.

Klevis Xhoxhi - Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, kryetare!

Falënderoj përfaqësuesit e ILDKPKI-së për prezantimin që i bënë buxhetit!

Me lejoni të them që projektbuxheti i vitit 2024 edhe për ILDKPKI-në rezulton me një rritje prej 19,1 milionë lekësh, ose 9,3 % më shumë, nga të cilat shpenzimet për paga janë rritur me 41,9 milionë lekë ose 23,4% më shumë; shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë rënë me 700 mijë lekë ose 2% më pak; shpenzimet për investime kanë rënë me 22 milionë lekë, që është rënia më e madhe, ose 88% më pak.

Projektbuxheti i parashikuar për vitin 2024 për ILDKPKI-në është parashikuar rreth 223,4 milionë lekë, nga të cilat 178,9 milionë lekë do të jenë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore; 41,3 milionë lekë do të jenë shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 3 milionë lekë do të jenë shpenzime për investime. Numri i punonjësve të ILDKPKI-së për vitin 2024 është parashikuar të jetë 73.

Po të krahasojmë realizimin e buxhetit për 9-mujorin e parë të vitit 2023, konstatojmë se është realizuar në masën 80% për shpenzime për paga; në masën 59% për shpenzime për mallra dhe shërbime dhe në masën 10,4% për shpenzime në investime.

Edhe përfaqësuesja e Inspektoratit e theksoi nevojën dhe kërkesën që ka institucioni për ndërhyrje në sistemin e serverëve. Kështu që, do të gjykoja që, pas diskutimit dhe sugjerimit së bashku me Ministrinë e Financave, ta vlerësojmë për t’ia paraqitur sugjerimet Komisionit të Ekonomisë.

Kjo ishte ajo lidhur me realizimin e buxhetit nga ana e ILDKPKI-së. Faleminderit!

Klotilda Bushka - Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Zonja Çausholli, fjala për ju.

Vilma Çausholli - Faleminderit, zonja kryetare!

Në lidhje me projektbuxhetin e Inspektoratit të Lartë të Deklarimit të Pasurive, sikurse e cituam, kemi një rritje, sidomos në shpenzimet korrente. Shprehem dakord me komentin dhe kërkesën e bërë nga Inspektorati në lidhje me shpenzimet e personelit, pasi nga ana jonë u konstatua që nuk ka qenë i azhurnuar në mënyrë të plotë struktura e miratuar së fundi nga Kuvendi, me një shtesë prej 3 punonjësish, dhe për këtë arsye do ta rivlerësojmë dhe një herë fondin e përlogaritur për Inspektoratin e Deklarimit të Pasurive.

Në lidhje me kërkesën për zërin e investimeve, do të thosha që ky është një diskutim që duhet të bëhet paraprakisht me institucionin nga ana jonë, pasi është një kërkesë shtesë e paraqitur sot dhe nuk është prezantuar më herët. Ndërkohë, për vitin 2023 kemi akorduar një fond 25 milionë lekë për investime, i cili nuk është realizuar ende nga institucioni. Prandaj, në përfundim do të thosha se kërkesa për investime është çështje, që duhet të vlerësohet në mënyrë më të detajuar mes institucionit dhe Ministrisë së Financave, për të gjykuar më tej nëse duhet të përfshihet dhe a ka mundësi të përfshihet ose jo në projektbuxhetin e vitit 2024.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Po, faleminderit, zonja Çausholli!

Zonja Gega, ju i keni paraqitur me shkrim në komision, në sekretarinë e komisionit këto që prezantuat? A janë diskutuar me Ministrinë e Financave më përpara?

Mirela Gega – Me Ministrinë e Financave, siç e theksova, është diskutuar vetëm diferenca në zërin “Shpenzime për paga dhe sigurime”, 600-601, ndërsa kërkesa shtesë për investime është depozituar pranë Komisionit të Ligjeve zyrtarisht. Me Ministrinë e Financave nuk ka qenë e mundur që kjo kërkesë të paraqitej brenda fazës së dytë, domethënë brenda muajit gusht, siç janë procedurat e përgatitjes....

Klotilda Bushka – Është depozituar sot shkresa?

Mirela Gega – Po, po.

Klotilda Bushka – Në rregull, që sekretaria t’ua shpërndajë të gjithë anëtarëve të komisionit bashkë me shkresat e tjera që kanë ardhur sot ose që do të vijnë.

Mirë, unë shoh që nevojat e ILDKPKI -së lidhen funksionet e punës. Kështu që, nisur nga kjo, njësoj si me çdo institucion tjetër, relatorët duhet të koordinojnë me institucionin dhe me Ministrinë e Financave për të parë cilat janë ato që lidhen me realizimin e funksioneve dhe cilat janë të domosdoshme, në mënyrë që, nëse ka një dakordësi dhe nëse buxheti e lejon, të adresohen. Pra, relatorët kanë për detyrë që t’i saktësojnë me Ministrinë e Financave dhe me institucionet këto çështje, që me pas në komision, kur të diskutojmë buxhetin nen për nen, ne të jemi të qartë për çfarë kërkohet, a janë të domosdoshme, a janë sipas prioriteteve dhe a janë mundësitë buxhetore për t’i adresuar ato.

Kështu që, ku do të jetë procesi, kohë keni mjaftueshëm, besoj, por, ju lutem, ndërkohë gjithë anëtarët e komisionit të marrin kërkesat që paraqesin këtu institucionet, edhe në formë shkresore, dhe kopja t’i dërgohet dhe Ministrisë së Financave, përveç relatorëve.

Mirë, ndonjë pyetje apo diskutim? Nuk ka.

Faleminderit, zoti Basholli!

Faleminderit, zonja Gega!

Jeni të lirë të shkoni.

Vijojmë me dëgjesën tjetër, me Gjykatën Kushtetuese.

Për këtë seancë dëgjimore kemi të pranishëm zotin Papandile, sekretar i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese, si dhe zotin Erion Tafaj, drejtor i Drejtorisë Ekonomike e Burimeve Njerëzore në Gjykatën Kushtetuese.

Mirë se erdhët!

Zoti Papandile, keni fjalën për të na prezantuar si janë treguesit e realizimit të buxhetit 2023, nevojat për vitin 2024, si adresohen ato në projektligj, si dhe çfarë keni ndonjë çështje tjetër, për të cilën doni ta vini në dijeni këtë komision.

Fjala për ju, zoti Papandile.

Eugen Papandile – Duke ju falënderuar për vëmendjen, tashmë kemi vite që, sipas procedurës, paraqitemi në Kuvend.

Paraprakisht, ju bëj me dije që unë shoqërohem nga zoti Erion Tafaj, siç e thatë, drejtor i Burimeve Njerëzore.

Përveç kërkesës që i kemi adresuar në datën e caktuar pranë Kuvendit, Komisionit të Ligjeve, dua të fokusohem në kërkesat dhe të jem më preciz në kërkesat që kemi ndaj projektbuxhetit të paraqitur për vitin 2024, kryesisht në lidhje me fondin për pagat, për sigurimet shoqërore dhe shpenzimet operative. Duke qenë që rritja është e ndjeshme në investime, por edhe aty kemi kërkesat tona, të cilat do t'i gjeni në mënyrë më të detajuar në relacionin që ju kemi dërguar, dhe, nëse keni komente të natyrës teknike, drejtori Ekonomik është këtu prezent dhe mund t'u përgjigjet pyetjeve teknike për sa u përket shifrave.

Pa humbur kohë, duke shqyrtuar projektbuxhetin e propozuar nga Ministria e Financave, shikojmë që disa nga kërkesat tona nuk kanë gjetur reflektim, sipas nevojave të adresuara dhe argumenteve që do t'ju paraqes në vijim.

Kështu, e nderuar kryetare,

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Struktura e Gjykatës Kushtetuese, sipas tavanit të miratuar, është në shumën 153 milionë e 800 mijë lekë për 62 punonjës. Në fakt, ju sjell në vëmendje që mbledhja e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, që e ka kompetencën, sipas ligjit, për të miratuar strukturën organizative të Gjykatës Kushtetuese, këtu po flas për organin më të lartë të gjykatës, të krijuar me ligj, ka miratuar një strukturë prej 78 punonjësish. Numri 62, që disa vite rresht na paraqitet nga Ministria e Financave, është një numër që nuk përkon me funksionimin e plotë të Gjykatës Kushtetuese dhe me punën apo volumin e krijuar nga dosjet e ardhura rishtazi, në të cilën duhet të përfshihen më shumë këshilltarë, ashtu siç është

miratuar në mbledhjen e gjyqtarëve, dhe më një numër punonjësish shtesë të natyrës civile, pra nëpunës civilë, me një shtesë prej 4 personash.

Në relacionin që keni përpara keni të detajuar numrin e çështjeve të shtuara ndër vite, nga viti 2020 dhe ato që parashikojmë për vitin 2024. Në vitin 2023 ne patëm parashikuar 400, nga 50 kërkesa, që ishin në vitin 2019. Pra, unë dua të argumentoj pjesën kronologjike të shtimit të numrit të punonjësve. Mbledhja e gjyqtarëve, për hir të së vërtetës, cakton strukturën organizative, dhe unë nuk do të doja, si çdo vit, të bëja një *deja vu*, që të paktën njëherë të mos kem kërkesa shtesë, por jemi të detyruar që ta bëjmë, pasi jemi të detyruar nga numri i volumit të çështjeve, pra po flasim për fondin e pagave, që parashikojmë 500 në vitin 2024. Pra, rritja e volumit të punës patjetër ka sjellë edhe rritjen e numrit të punonjësve, ose në këtë rast të këshilltarëve, të cilët merren me trajtimin e kërkesave në ndihmë të gjyqtarëve, e përsëris këtë, pra të plotësimit të trupës. Ndërkohë, ne kishim vite që kishim me vakanca dhe numri i personelit 62 nuk përkon me atë çfarë ka miratuar së fundi mbledhja e gjyqtarëve. Kjo për sa i përket anës strukturore organizative.

Për sa i përket pjesës tjetër, shpenzimeve operative, po ashtu nga kërkesat tona nuk është plotësuar e gjithë, sipas shifrave, nevoja që ka gjykata, që lidhet edhe me fluksin dhe volumin e çështjeve. Nga ana tjetër, shpenzimet operative të gjykatës u parashikuan nga ana jonë në atë mënyrë, pra nuk po futem në shifra, sepse mund të ngatërrohem, si jurist që jam, për shkak se gjykata jonë ka marrë përsipër disa aktiviteteve shumë të rëndësishme në vitin në vijim, aktivitete të parashikuara në Tiranë më 1-2 shkurt 2024. Për shkak se Gjykata Kushtetuese është pjesë e shoqatës së gjykatave frankofone është propozuar që ky aktivitet të zhvillohet në Tiranë.

Ju bëj me dije se, përveç ngritjes së prestigjit të Gjykatës Kushtetuese, kjo shkon paralelisht me ngritjen e prestigjit të vetë shtetit shqiptar. Kjo pjesë, duke u bërë anëtare me të drejta të plota, bëhet *de facto* pronësi e shtetit, pronësi në termin figurativ. Po e njëjta gjë është propozuar nga forumi i gjykatave ballkanike kushtetuese, pra është një iniciativë e Gjykatës Kushtetuese të Bullgarisë, që më 2024-ën forumi i gjykatave kushtetuese të zhvillohet në Tiranë. Pra, përveç punës operative, këto që kemi kërkuar ne janë tregues shifrorë minimalë për një punë dhe për një funksionim normal të Gjykatës Kushtetuese.

Pjesëmarrja në këto aktivitete, po e theksoj dhe një herë, do të rrisë prestigjin e Gjykatës Kushtetuese dhe të shtetit shqiptar në arenën ndërkombëtare bën që ato që na janë ofruar, pra shifrat për shpenzimet operative nga Ministria e Financave, nuk mjaftojnë. Këtë e them me bindje të plotë. Madje edhe vitin e kaluar patëm kërkesa të njëjta dhe vetëm (*Ndërprerje incizimi*) në fund na shpëtoi sa u takon shpenzimeve operative, duke pasur

parasysh që më 27 nëntor kemi një aktivitet të rëndësishëm për shkak të 25-vjetorit të Kushtetutës.

Po të ecim më tej me argumentin, unë e kuptoj që për institucionet e tjera shteti bën edhe politikën sa i takon transparencës dhe ngritjes së mirëqenies, por në Gjykatën Kushtetuese nuk prodhohet politikë, por drejtësi, ose synohet. Pra, ne nuk mund të negociojmë në terma me institucionet e tjera. Kështu që, unë mendoj se duhet ta veçoni Gjykatën Kushtetuese, pikërisht për këtë shkak, dhe jo ta mbani me hatër.

Sa i takon buxhetit të vitit 2023 në shifra, pa marrë parasysh një VKM nga fondi rezervë, që u dha në korrik të këtij viti, të cilën mund ta shpjegojmë më vonë ose unë, ose drejtori, në lidhje me fondin e pagave kemi një arritje 87%, shpenzime operative 87% dhe investime, sipas investimit dhe sipas zërit fillestar, 96%. Këto janë realizimet.

Unë i lashë për në fund, pasi u fokusova te pretendimet që kishim për zërat e tjerë, si fondi i pagave dhe shpenzime operative. Patjetër, në mënyrë të detajuar kemi edhe kërkesa për investime, por, për hir të së vërtetës, ky vit ka rritje goxha të kënaqshme në zërin “Investime” në parashikimin buxhetor të Ministrisë së Financave.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Papandile!

Sekretaria do t’u shpërndajë kolegëve shkresën e ardhur për kërkesat shtesë që ju keni bërë në komision. Në fakt, shkresa ka ardhur dje pasdite, kështu që sekretaria sot e ka marrë nga protokolli, dhe do ta shpërndajë.

Ndërkohë, do t’ia jap fjalën zotit Xhoxhi dhe më pas zonjës Çausholli, pastaj do të bëjmë një diskutim në lidhje me kërkesat tuaja.

Po, zoti Xhoxhi.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, kryetare!

Sa i takon projektbuxhetit për vitin 2024 të parashikuar për Gjykatën Kushtetuese, ai është rreth 209,3 milionë lekë, nga të cilat 153, 8 milionë lekë do të jenë për shpenzime, paga dhe sigurime shoqërore; 30,5 milionë lekë do të jenë shpenzime për mallra dhe shërbime; 24 milionë lekë do të jenë shpenzime për investime.

Numri i punonjësve për Gjykatën Kushtetuese për vitin 2024 është parashikuar të jetë 62. Po të bëjmë krahasimin me buxhetin e vitit 2023, në projektbuxhetin e vitit 2024 do të shohim që ka një rritje prej 32,5 milionë lekësh ose rreth 18,6% më shumë, nga të cilat për pagat kemi një rritje prej 20,8 milionë lekësh, ose 15,6% më shumë, te shpenzimet për mallra dhe shërbime ka një rënie në 4 milionë lekë ose 11,6% më pak, dhe te shpenzimet për investime ka një dyfishim, pra një rritje prej 16 milionë lekësh.

Po të krahasojmë 9-mujorin e parë, në fakt, unë e dëgjova me vëmendje dhe kam një mosrakordim të zëri i investimeve, nuk e di, ndoshta gjatë kësaj periudhe Gjykata Kushtetuese mund ta ketë realizuar zërin e investimeve, pra gjatë muajit të fundit, sepse gjatë 9-mujorit të parë mua zëri i investimeve më rezulton i perealizuar, ndërkohë që shpenzimet për paga janë realizuar në masën 82% dhe për mallra dhe shërbime në masën 76,5%.

Gjykata Kushtetuese ka paraqitur kërkesa, që i prezantoi edhe sekretari i Përgjithshëm, për të bërë ndryshime në projektbuxhet, pra kërkon shtesa mbi tavanet buxhetore në vlerën 143 milionë lekë, nga të cilat 107 milionë lekë i kërkon shtesë të shpenzimet dhe pagat, me argumentin për të përballuar koston financiare të strukturës së re të miratuar nga mbledhja e gjyqtarëve, ku numri i përgjithshëm i punonjësve ka shkuar në 78 punonjës, nga të cilët 12 janë këshilltarë dhe 4 nëpunës civilë; 22,35 milionë lekë shtesë në shpenzime për mallra dhe shërbime, kërkojnë edhe një shtesë tjetër prej 13,8 milionë lekësh në zërin e investimeve për të realizuar edhe investimet e kërkuara, që sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës Kushtetuese i prezantoi.

Kolegë, kjo ishte tabloja e projektbuxhetit të vitit 2024 dhe ajo e realizimit të vitit 2023, gjithashtu edhe kërkesat që parashtroi Gjykata Kushtetuese, që do t'i kemi parasysh në vlerësimin dhe diskutimin që do të bëjmë qoftë me Ministrinë e Financave, por dhe mes nesh, për t'ia sugjeruar pastaj Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Fjalën e ka zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zonja kryetare!

Është e rëndësishme të theksojmë që buxhet i Gjykatës Kushtetuese ka pasur një mbështetje të ndjeshme, që pasqyrohet edhe në rritjen e fondeve buxhetore, që janë akorduar në buxhetin e parashikuar për vitin 2024, madje edhe më përpara, me aktin normativ të vitit 2023, është mbështetur me rritje të fondeve buxhetore.

Lidhur me kërkesat përtej arritjeve, që janë parashikuar në masën 18,6% për vitin 2024, ne do ta lënë në vlerësimin e këtij komisioni për të gjykuar dhe vlerësuar kërkesat e paraqitura nga institucioni i Gjykatës Kushtetuese.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Çausholli!

Në fakt, nga treguesit e realizimit dhe nga nevojat e reja që paraqiten për t'u adresuar në projektbuxhetin e vitit 2024, pra që nuk janë në projektligj, por kërkohen shtesë, vë re që në thelb, që ta kuptojmë të gjithë, (sepse puna e shifrave është shumë teknike), kërkohen 12

këshilltarë dhe vetëm 4 nëpunës civilë (kjo argumentohet me nivelin e rritjes së punës dhe të ngarkesës së çështjeve, pra hyn në detyrat funksionale); kërkohet një shtesë sa i takon zërit “Mallra dhe shërbime” për nevojat të shtuara të gjykatës, që është tërësisht funksionale, punon me kapacitet të plotë, sepse para pak vitesh nuk e ka pasur kapacitetin e plotë, pra pati atë periudhën e pauzës. Pra, edhe kërkesat kanë një linjë logjike dhe lidhen me detyrat funksionale.

Për më tepër, për organizimin e mbledhjeve ndërkombëtare në Shqipëri ne i kemi nxitur institucionet që të organizojnë sa më shumë aktivitete ndërkombëtar në Shqipëri, sepse kjo është një mënyrë e mirë edhe për rritjen e kapaciteteve tona, por edhe për njohjen e aftësive tona në botë. Këto nuk janë kosto kaq të rëndësishme apo thelbësore, të cilat mund ta dëmtojnë aq shumë buxhetin e një institucioni karshi të mirave që i sjellin vendit.

Ndërkohë, te shtesat në zërin “Investime”, nëse nuk gabohe, në relacionin që kam marrë nga shërbimet e Kuvendit, bëhet fjalë për realizimin e investimeve, si: mbrojtja nga zjarri, pajisje zyrash, informatizim të veprimtarisë, biblioteka dhe rikonstruksioni i godinës.

Vitin e kaluar në mbledhjen e komisionit kemi diskutuar për rikonstruksionin e godinës, por për efekt të mundësive buxhetore dhe prioritizimit kemi dhënë fonde për riorganizimin e sallës së mbledhjeve plenare, nuk di të shprehem për numrin në strukturë, pasi është një çështje tërësisht financiare dhe është pjesë e parashikimit të posaçëm në ligjin e buxhetit të shtetit. Pa diskutim, në këtë drejtim duhet të rakordohet çdo kërkesë me Ministrinë e Financave, por edhe kërkesa të tjera.

Thënë këtë, do të doja që Ministria e Financave të merrte kërkesat shtesë, të cilat janë dërguar zyrtarisht në komision dhe po u shpërndahen të gjithë anëtarëve të komisionit, siç do t'i shpërndahen edhe Ministrisë së Financave, dhe relatorët të rakordohen me institucionin për të kuptuar, sipas kriterëve që kemi vendosur për mbështetjen e institucioneve në buxhetin e vitit 2024, kërkesat e domosdoshme, pra ato që i shërbejnë realizimit të funksioneve sa mirë, përkundrajt edhe rezultateve pozitive që presim nga puna e çdo institucioni. Thënë këtë, unë mendoj se do të kemi kohë ta diskutojmë në detaje rezultatin e koordinimit midis institucioneve, kur në mbledhjen e këtij komisioni do të vendosim për miratimin e buxhetit nen për nen.

Shoh që nga kolegët nuk e ka kërkuar kush fjalën, nuk ka ndonjë diskutim tjetër.

Faleminderit, zoti Papandile dhe zoti Tafaj!

Jeni të lirë të shkoni.

Eugen Papandile – Faleminderit juve!

Ditë të mbarë!

Klotilda Bushka – Viojmë me institucionin tjetër, po aq të rëndësishëm, Komisionerët Publikë.

Shoh që *online* janë zoti Florian Ballhysa dhe zonja Irena Nino, të dy komisionerë publikë, si dhe Alketa Çeli, kancelare e Komisionerëve Publikë.

Mirë se erdhët në mbledhjen *online*!

Keni qenë *online*, na keni ndjekur, keni qenë edhe vitet e tjera.

Për të mos bërë përsëritje, po ia jap fjalën zotit Ballhysa për të bërë prezantimin e nevojave të institucionit tuaj.

Po, zoti Ballhysa.

Florian Ballhysa - Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar anëtarë të Komisionit të Ligjeve,

Besoj se për shkak të një kapriçoje elektronike të planifikimit të kalendarit tuaj, Komisionerët Publikë vijnë këtë vit në dëgjesë të ndarë nga institucionet e tjera të vetingut, të cilët ju i dëgjuat ditën e djeshme, kështu që do të kërkoja mirëkuptimin dhe durimin tuaj për të paraqitur disa çështje, që meritojnë vëmendje dhe që janë deri diku të përbashkëta me ato që parashtruan dje kryetari i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe sekretari i Përgjithshëm i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Fillimisht do të parashtroj që, në përgjigje të kërkesës së komisionit, çështjet që do të prezantohen sot institucioni i Komisionerëve Publikë i ka paraqitur me shkrim në datën 3 nëntor dhe besoj se secili prej jush është pajisur me një kopje të atij materiali, çka do ta lehtësonte këtë dëgjesë, njëkohësisht, do të kursente edhe kohën tuaj, të nderuar anëtarë të komisionit.

Së pari, dua të ndalem te kërkesa që ne kemi adresuar te komisioni në korrik të vitit 2023, për rishikimin e strukturës së institucionit nëpërmjet një vendimi të Kuvendit, në përputhje me VKM-në nr. 325 në maj të vitit 2023, vendim që rikategorizoi të gjitha pozicionet në administratën shtetërore, që për rrjedhojë, për efekt të përlogaritjes së pagës, është reflektuar, sipas VKM-së, në kërkesën tonë për efekt zbatimi. Po ashtu, në atë kërkesë ne kemi kërkuar edhe një riklasifikim për tri pozicione pune, 2 drejtorë drejtorie dhe koordinatoren për media dhe marrëdhëniet me jashtë. Argumentet i kemi trajtuar në shkresën që ju kemi përcjellë dhe jua jemi ripërcjellë atë shkresë bashkë me materialin e paraqitur pranë jush të datës 3 nëntor.

Efekti financiar në rastin e institucionit të Komisionarëve Publikë r është shumë i vogël dhe, nëse miratohet, pra nëse gjen dakordësinë e këtij komisioni të Kuvendit, ky riklasifikim nuk ka efekt në buxhetin e këtij viti, pasi, ndryshe nga institucionet e tjera të

vetingut që kanë paraqitur kërkesa për shtesa në strukturë, institucioni i Komisionerëve Publikë ka vetëm këto kërkesa sa i takon anës strukturore.

Në lidhje me buxhetin e vitit 2024, hartimi është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 84, të vitit 2016 dhe nr. 96 të vitit 2016, sikurse dhe vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 35 të vitit 2022, që i ka filluar efektet e tij në janar të vitit 2023.

Në këtë kuadër, sikundër edhe institucionet e tjera të vetingut, shprehet nevoja për një shtesë në buxhetin e propozuar lidhur me efektet financiare të prapambetura, në zbatim të këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, për rilogaritjen e pagës së komisionerëve të tij dhe këshilltarëve të njësisë ligjore prej fillimit të aktivitetit të institucionit. Kjo vlerë shkon në 30 milionë lekë dhe duket se përbën një vlerë krahasimisht jo të konsiderueshme me efektin total për sistemin e drejtësisë dhe është pasqyruar në kërkesat tona buxhetore.

Sikundër e theksuan edhe dy institucionet e tjera të vetingut, duhet mbajtur parasysh afati i kufizuar i mandatit për përfitimin e këtyre pagesave të prapambetura, si dhe çështjet që kanë të bëjnë drejtpërdrejt me disa kufizime etike, që e bëjnë edhe më të vështirë për përfaqësuesit e institucioneve të vetingut që t'u drejtohen gjykatave për përfitimin e kësaj të drejte, sikundër po bëjnë një pjesë e magjistratëve.

Ndërkohë, dua të përfitoj nga ky rast, pasi jemi për herë të fundit këtu në komision duke folur për buxhetin afatmesëm, për t'ju parashtruar se në vitin 2025 duhet të kemi një buxhet të parashikuar për institucionin, pasi për shkak të parashikimeve ligjore, neni 70 i ligjit nr. 84 të vitit 2016, një pjesë e administratës, me miratimin e Kuvendit, do të vazhdojë aktivitetin deri në mbylljen e institucionit. Ky parashikim duhet të jetë fryt i një diskutimi konstant gjatë vitit që vjen me Kuvendin, me ju të nderuar të komisionit, për të miratuar aktet e nevojshme, por në këtë moment doja t'ju sillja në vëmendje, si hera e fundit që prezantoj buxhetin afatmesëm para jush.

Gjithashtu, më lejoni të sjell në vëmendje se në mënyrë të përsëritur kemi paraqitur para jush, nëpërmjet komunikimit shkresor, nevojën për garantimin e statusit pas përfundimit të mandatit për punonjësit, e përsëris, e njësisë ligjore dhe asaj administrative të këtij institucioni. Kemi bërë propozime konkrete për nevojat e ndërhyrjes në legjislacion, me qëllim që këtyre punonjësve, që kanë përfituar një eksperiencë mjaft të vlefshme gjatë këtyre 7 vjetëve, në përfundim të mandatit të mos ju humbasë kjo eksperiencë, por të përdoret në dobi të sistemit dhe institucioneve publike. Ju faleminderit!

Klotilda Bushka – Shumë faleminderit, zoti Ballhysa, që ishit konciz, edhe pse ngritët shumë çështje në mënyrë eficiente!

Zonja Nino keni gjë për të shtuar? Nuk keni.

Dakord. Faleminderit!

Fjalën e ka zoti Xhoxhi, më pas zonja Çausholli.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Falënderoj Komisionerët Publikë për të gjithë prezantimin që bënë!

Më lejoni të theksoj se projektbuxheti për vitin 2024 për Komisionerët Publikë është rreth 113,4 milionë lekë, nga të cilat 99,7 milionë lekë do të jenë shpenzime për pagat dhe sigurimet shoqërore; 12,2 milionë lekë do të jenë shpenzime për mallra dhe shërbime; 1,5 milionë lekë do të jenë shpenzime për investime. Ndërkohë, numri i punonjësve të Komisionerët Publikë për vitin 2024 parashikohet të jetë 30.

Po të krahasojmë buxhetin e vitin 2023 me projektbuxhetin e vitit 2024, për Komisionerin kemi një rritje prej 23,2 milionë lekësh, ose 25,7% më shumë, ku shpenzimet për paga janë rritur në 23,3 milionë lekë, ose 26% më shumë; shpenzimet për mallra dhe shërbime kanë një rritje prej 2,9 milionë lekësh, ose 31% më shumë, ndërsa shpenzimet për investime nuk kanë ndryshuar.

Nga të dhënat për realizimin e buxhetit të vitit 2023, pra në 9-mujorin e parë të vitit 2023, kemi një realizim në masën 79% për shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, në masën 33% për shpenzime për mallra dhe shërbime, kurse në zërin e “Investime” nuk kemi realizim.

Komisioneri paraqiti kërkesat e tij buxhetore, por unë do të ndalem te kërkesat që ka bërë për shtim fondesh, kryesisht në zërin e pagave në masën 30 milionë lekë, kjo në varësi të efektit që ka thënë edhe vendimi i Gjykatës Kushtetuese për pagat dhe magjistratëve.

Kjo ishte panorama e projektbuxhetit të vitit 2024 për Komisionerët Publikë dhe realizimi i buxheti për vitin 2023. Kështu që, bashkë me Ministrinë e Financave dhe me ju kolegë, pas diskutimeve dhe sugjerimeve, do t’ia adresojmë Komisionit të Ekonomisë.

Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Xhoxhi!

Fjala për ju zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Faleminderit!

Mendoj se tashmë gjërat u thanë, institucioni në vitin 2024 ka një rritje të ndjeshme, që në vlera absolute janë vlera të vogla, sepse është një institucion modest, me 30 punonjës, dhe rritja me 26% e totalit të buxhetit është domethënëse për mbështetjen që i është dhënë në këtij institucioni buxhetin e vitit 2024.

Lidhur me problematikat e tjera, ato janë çështje që janë për vlerësim dhe diskutim nga ana juaj, si komision. Ju faleminderit!

Klotilda Bushka – Në lidhje me çështjet e ngritura nga zoti Ballhysa, që besoj se janë njësoj edhe për zonjën Nino, sepse përfaqësojnë të njëjtin institucion, nuk arritëm dot t'i kishim të gjitha institucionet e vetingut dje, por disa çështje i keni nisur. Më lejoni të sqaroj që për pagesat e prapambetura, si pasojë e zbatimit të vendimit të Gjykatës Kushtetuese, siç e thashë edhe dje, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe komisioni do të rakordojnë bashkë me ju për një zgjidhje ligjore institucionale. Viti 2023 nuk ka mbaruar akoma, kështu që jemi ende duke punuar dhe shumë shpejt do të njoftohen të gjitha institucionet e afektuara nga vendimi i Gjykatës Kushtetuese sa u takon pagesave të prapambetura për takim zyrtar.

Për Komisionerët Publikë, ashtu si për Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, ka një specifikë, sepse afati mbaron më shpejt, ndaj duhet të këtë një zgjidhje më afatshkurtër.

Sa u takon çështjeve, që ju ngrini me të drejtë për vitin 2025, edhe Ministria e Financave, që është e pranishme, duhet ta mbajë këtë në konsideratë, pra i takon buxhetimit për vitin 2025 për mbylljen e institucionit.

Sigurisht, ne do të jemi në kontakt zyrtar me ministrinë dhe institucionin, jo vetëm me komisionarët, por edhe me Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, sepse do të kenë të njëjtat çështje për trajtim dhe zgjidhje.

Edhe sa i takon statusit të punonjësve, të cilët janë tashmë në punë dhe do të dalin me një eksperiencë shumë të vlefshme për administratën publike, do të duhet ta shohim, kështu që faleminderit që e ngritët këtë çështje. Ne kemi kërkesat tuaja, jemi duke i trajtuar dhe jemi në proces konsultimi.

Në lidhje me nevojat buxhetore për shtesat e vitit 2024, unë shoh që hyn brenda nevojave të funksionimit të institucionit janë shifra që nuk kanë ndonjë efekt aq të madh në buxhet dhe do të doja t'u rakordonim midis Ministrisë së Financave, institucionit, relatorëve dhe Komisionit të Ligjeve që ne të kemi një panoramë të qartë dhe më pas, kur ta diskutojmë për sugjerimet që do t'i bëjmë Komisionit të Ekonomisë, të kemi një qëndrim të saktë.

A ka ndonjë diskutim tjetër? Në rregull!

Zoti Ballhysa dhe zonja Nino, faleminderit dhe punë të mbarë! Jeni të lirë të shkoni!

Mbyllet dëgjesa.

Vijojmë me dëgjesën tjetër që, nëse nuk gaboj, është e fundit, me Presidencën. A është prezente zonja Valbona Lusha, sekretare e Përgjithshme e institucionit të Presidencës?

Valbona Lusha – Përshëndetje!

Klotilda Bushka – A janë prezentë zoti Arjan Kadareja, këshilltar i Presidentit të Republikës dhe zoti Ildir Gjata?

Arjan Kadareja – Mirëdita!

Idlir Gjata – Mirëdita!

Klotilda Bushka – Mirëdita!

Mirëserdhët në mbledhjen tonë *online*!

Zonja Lusha, do ta merrni ju fjalën për prezantimin e realizimit të treguesve buxhetorë për vitin 2023, për nevojat për vitin 2024 dhe sa adresohen ato në buxhet (objekt i të cilit është projektligji që kemi sot për shqyrtim).

Fjala për ju.

Valbona Lusha – E nderuar zonja kryetare,

Të nderuar deputetë,

Ju falënderoj për mundësinë e kësaj dëgjese!

Institucioni i Presidentit të Republikës ka përgatitur dhe ka parashtruar kërkesat buxhetore në një material të detajuar, ku janë evidentuar nevojat institucionale për vitin 2024, të cilat në një periudhë të konsiderueshme janë vlerësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, duke u përfshirë në projektbuxhetin e vitit 2024. Me këtë rast e falënderoj Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për bashkëpunimin!

Buxheti i vitit 2023 deri në datën 7 nëntor të vitit 2023 është realizuar në masën 80% dhe deri në fund të vitit është parashikuar të realizohet në masën 97-98%, sepse të gjitha procedurat e prokurimit, sipas regjistrit të parashikimeve, janë në proces përfundimi. Në vitin 2023 shpenzimet korrente ndahen si më poshtë: shpenzimet për paga dhe sigurimet shoqërore zënë 48% të buxhetit dhe këto shpenzime deri tani janë realizuar në masën 90%; shpenzimet për materiale dhe shërbime zënë 52% të buxhetit dhe këto shpenzime deri tani janë realizuar në masën 80%, ku jemi në përfundim të procedurave të prokurimit dhe në proces likuidimi ndaj të tretëve dhe operatorëve ekonomikë.

Në lidhje me investimet, realizimi për vitin 2023 pritet që të jetë në masën 100%, pasi kanë përfunduar procedurat e prokurimit dhe procesi i likuidimit. Në buxhetin e vitit 2024 një vend të rëndësishëm zënë investimet e planifikuara për vitet 2024-2026 për rikonstruksionin e godinës ekzistuese të institucionit të Presidencës së Republikës (kjo godinë ka pasur ndërhyrje rikonstruksioni që prej vitit 2008), sepse aktualisht janë evidentuar shumë sisteme jofunksionale, duke cenuar elementet e sigurisë dhe kushtet normale të punës. Në periudhën 15-vjeçare janë realizuar vetëm shërbime mirëmbajtjeje dhe rikonstruksioni të pjesshme.

Së dyti, për sa u përket investimeve, theksojmë se ndërtimi i sistemit të serverëve përbën një domosdoshmëri emergjente për institucionin e Presidentit të Republikës, në kuadër të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe nevojave të

institucionit për shkak të infrastrukturës së rrjetit të brendshëm që është vjetruar dhe nuk përshatet me programet e reja dhe zhvillimin e teknologjisë.

Investimi në pajisje për mobilim zyrash, që parashikohet të shtrihet në vitet 2024, 2025 dhe 2026, është një investim i nevojshëm për godinën që do të rikonstruktohet në një sipërfaqe ndërtimi prej 3000 metrash katrorë, me 2 dhe 3 kate dhe me 1 kat nëntokë.

Së katërti, investimet për pajisje kompjuterike dhe elektronike parashikohen të shtrihen në vitet 2024-2026. Ky investim përbën një domosdoshmëri për plotësimin e nevojave të institucionit dhe punonjësve për ushtrimin e funksioneve të tyre zyrtare. Ndërkohë, do të kërkonim të merren parasysh kërkesat e paraqitura me shkrim nga ana e institucionit për një mbështetje në mjetet e transportit në buxhetin afatmesëm 2024-2026. Kjo kërkesë mbështetet në analizën mbi nevojat e institucionit dhe vlerësimin e karakteristikave të mjeteve ekzistuese për sa i përket amortizimit të tyre në vite, kohës së përdorimit dhe elementeve të sigurisë së tyre. Ju falënderoj për vëmendjen!

Klotilda Bushka – Ju faleminderit!

Fjala për zotin Xhoxhi, më pas fjala për zonjën Çausholli.

Klevis Xhoxhi – Faleminderit, kryetare!

Falënderoj edhe përfaqësuesen e Presidentcës!

Kolegë, më lejoni të them se buxheti i parashikuar për vitin 2024 për institucionin e Presidentit është rreth 635,5 milionë lekë, nga të cilat 193,4 milionë lekë janë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore, 136,1 milionë lekë janë shpenzime për mallra dhe shërbime dhe 306 milionë lekë janë shpenzime për investime. Numri i punonjësve të institucionit të Presidentcës për vitin 2024 është parashikuar të jetë 93 punonjës. Po ta krahasojmë buxhetin e vitit 2023 me projektbuxhetin e vitit 2024, kemi një rritje për institucionin e Presidentit me rreth 369 milionë lekë, nga këto për paga kemi një rritje prej 20 milionë lekësh ose 16,8% më shumë; për mallra dhe shërbime kemi një rritje prej 5,1 milionë lekësh ose 3,9% më shumë dhe shpenzimet për investimet janë rritur në rreth 290 milionë lekë. Po të krahasojmë realizimin e 9-mujorit të parë të buxhetit të vitit 2023, për institucionin e Presidentit kemi një realizim të shpenzimeve për paga në masën 63%, të shpenzimeve për mallra dhe shërbime në masën 59% dhe të shpenzimeve për investime në masën 17,5%, por këto shifra, ashtu sikundër tha edhe përfaqësuesja e Presidentcës, kanë ndryshuar për shkak të realizimit të lidhjes së kontratave gjatë muajve të fundit. Kërkesat buxhetore për rritjen e taveve buxhetore, përtej parashikimit të projektbuxhetit për vitin 2024, i përmendi përfaqësuesja e Presidentcës, kështu që, kolegë, bashkë me Ministrinë e Financave dhe me sugjerimet tuaja do të shikojmë të ezaurojmë gjithçka për t'ia paraqitur Komisionit të Ekonomisë. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit!

Fjala për ju, zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Faleminderit, zonja kryetare!

Do të doja ta nisja duke e falënderuar institucionin e Presidencës, sepse ka qenë gjithmonë një institucion që ka paraqitur kërkesa imediate dhe të domosdoshme, prandaj ka pasur ndër vite një buxhetim të qëndrueshëm (sigurisht, kanë ardhur gjithmonë në vlera rritëse)! Për vitin 2024 buxheti i institucionit njeh një rritje të konsiderueshme edhe për shkak të përfshirjes së një investimi të konsiderueshëm për këtë institucion, i cili është një projekt i ri dhe që shtrihet në harkun kohor të 3 vjetëve 2024, 2025 dhe 2026. Pra, ky është një parashikim i plotë i projektit i buxhetuar gjatë këtij viti nga Ministria e Financave. Do të thosha se kërkesat e institucionit, që lidhen me shpenzimet, janë përmbushur nga fondet e akorduara për vitin 2024, ndërsa kërkesat për rritje të investimit për blerjen e mjeteve të reja është një çështje që mund të vlerësohet edhe duke parë ecurinë e investimeve të akorduara, të cilat janë të konsiderueshme për institucionin e Presidencës. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zonja Çausholli!

Nuk shoh dikë nga kolegët që të kërkojë fjalën, kështu që po ndalem pak tek institucioni i Presidentit. Ne patëm bërë diskutime vjet, sepse u kërkuan investime për sisteme sigurie brenda godinës dhe shoh që shpenzimet kanë shkuar në 17,5% vetëm për 9 muajt e parë të vitit, më pas niveli i investimeve ndoshta është rritur, dhe këtë dua ta them, për të gjitha institucionet.

Zonja Çausholli, një pjesë e madhe e institucioneve i kanë të ulët treguesit e realizimit të shpenzimeve për vitin 2023, konkretisht ata tregues që lidhen me investimet. Ju jeni organi kompetent për ta vlerësuar këtë, por, me sa di unë, nga ata që kanë qenë gjithmonë relatorë, edhe nga relatorët këtu, por edhe nga kolegët e Komisionit të Ekonomisë, ky është një nga ata tregues që merret për bazë për planifikimin e buxhetit të vitit pasardhës. Kështu që do të doja që, kur të rakordohemi me institucionet, ta kemi në konsideratë këtë për të pasur një standard me të gjitha institucionet. Pra, mund të ketë arsye objektive dhe arsye të përligjura, sipas planifikimit buxhetor, kur ka vonesa, por mund të ketë edhe arsye të tjera që nuk janë të tilla, kështu që do të duhet të kemi një trajtim të barabartë dhe me të njëjtin standard për të gjitha institucionet në këtë drejtim. Ky do të ishte një sugjerim nga ana ime për relatorët dhe për Ministrinë e Financave.

Sa i takon kërkesës që ju bëni sot, zonja Lusha, për buxhetin afatmesëm të viteve 2024-2026, mua më duket një kërkesë që nuk hyn te prioritetet, sepse prioritet janë çështjet e tjera për të cilat ju keni rakorduar me Ministrinë e Financave, por sigurisht që unë do të pres

se çfarë rakordimi do të bëjnë relatorët, Ministria e Financave dhe institucioni për ta adresuar edhe këtë çështje.

Po, zonja Çausholli.

Vilma Çausholli – Desha të them se në çdo rast Ministria e Financave i është referuar realizimit të një viti të mëparshëm, jo vetëm të shpenzimeve për investime, por për të gjitha realizimeve faktike të buxhetit që është një tregues të cilin duhet ta kenë në konsideratë të gjitha institucionet që do të ndikojnë në planifikimin e buxhetit për vitin e ardhshëm. Në këtë rast nuk flitet për një rritje të investimeve që lidhen me investimet për blerje pajisjesh, blerje kompjuterësh ose për projekte minimaliste, por lidhet me investimin që do të bëhet për rikonstruksionin e godinës së Presidencës. Dua të them se kjo rritje e konsiderueshme vjen vetëm në kuadër të ndërmarrjes së një projekti të ri, jo për projekte që, ashtu siç e thatë edhe ju, nuk janë prioritare për vitin 2024. Ky ishte thjesht një sqarim. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Më vjen shumë mirë. Shumë faleminderit, zonja Çausholli!

Arjan Kadareja – Të them diçka?

Klotilda Bushka – Po, zoti Kadareja, fjala për ju.

Arjan Kadareja – Faleminderit!

Për çështjen e realizimit të investimeve, investimi kryesor gjatë këtij viti është parashikuar projekti i rikonstruksionit që është në përfundim dhe për të cilin do të likuidohet pala që e ka kryer projektin. Pra, kjo është arsyeja pse projekti nuk është futur akoma, por projekti është gati dhe, mbi bazën e atij projekti, do të bëhet investimi që u përmend (rikonstruksioni i ndërtesës).

Për sa i përket kërkesës për mjete, është e vërtetë që ne këtë kërkesë e kemi bërë për 3 vjet, duke marrë parasysh ngushticat normale të buxhetit, por unë mendoj se situata duhet plotësuar gradualisht, sepse ka 5 vjet që institucioni i Presidencës nuk merr një mjet të ri. Pra, flota është vjetruar. Gjatë këtij viti ne kemi nxjerrë nga funksioni 7 mjete, por edhe 2 mjete të tjera që i përdorim duhen nxjerrë nga funksioni, sepse e kanë kaluar “moshën”. Përveç kësaj një mjet nuk e kemi funksional, pra nuk kryen funksionin për të cilin është, megjithëse përdoret dhe një mjet tjetër e kemi në remont, që do të thotë se nuk është i përdorshëm. Për këtë arsye ne do të kërkonim që kërkesa, megjithëse është bërë për 3 vjet, të plotësohet gradualisht, ashtu sikurse edhe rikonstruksioni është plotësuar për 3 vjet. Pra, investimet kapitale për rikonstruksionin janë për 3 vjet. Në këtë mënyrë mendojmë se duhet të plotësohet edhe kërkesa për mjete. Faleminderit!

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Kadareja!

Po, fjala për ju, zoti Gjata.

Idlir Gjata – Doja të bëja një ndërhyrje, se edhe vetë Ministria e Financave është e qartë që jemi në diskutime për godinën e re që në muajin maj, dhe një pjesë e shpenzimeve kapitale nuk mund të realizoheshin, sepse mund të dilnin jashtë përdorimit, duke qenë se duhet të projektonim godinën e re. Kjo është edhe një nga arsyet për mosrealizimin deri në këtë periudhë. Tani që kemi rënë dakord, se është parë edhe në projektbuxhet, po veprojmë edhe më shpejt, brenda hapësirës ligjore, që është 15 tetori.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti Gjata!

Në fakt, komenti im ishte për të gjitha institucionet (mora shkas nga kjo dëgjësë) dhe kishte të bënte më shumë me rakordimin mes Ministrisë së Financave dhe relatorëve që më pas do të duhet të paraqesin një material të rakorduar me institucionet, ta diskutojmë në komision dhe të vendosim, sepse edhe neve na duhet që të jemi të qartë për çështjet që trajtojmë. Sigurisht që ne do të kërkojmë standarde të barabarta dhe do të mbështesim nevojat e institucioneve që janë të domosdoshme, që ndihmojnë në eficiencën e punës dhe në realizimin e funksioneve të tyre, sipas një rendi prioritar dhe sipas mundësive buxhetore.

Kështu që, përfaqësues të Presidencës, ju falënderoj dhe jeni të lirë të shkoni!

Kolegë, ne mbaruam me dëgjesat. Falënderoj relatorët, zonjën Çausholli, të gjithë kolegët që ishin *online*, përfaqësuesit dhe të ftuarit, sekretarinë e komisionit, shërbimet e IT-së që bëjnë të mundur realizimin e mbledhjes në këtë formë, të gjithë ata që kontribuan në këtë mbledhje! Ju uroj një ditë të mbarë!

Faleminderit!

Mbyllet mbledhja.

MBYLLET MBLEDHJA

